

Dy të dyshuar për vrasjen e policit Muhamed Lika

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI NIS BISEDIMET ME PAKICAT PËR QEVERINË E RE

FAQE 4-5



Kryeministri në detyrë, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, partia e të cilit ka fituar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, ka nisur takimet me partitë politike të pakicave,

për t'u konsultuar rreth formimit të qeverisë së re të vendit. Ai të mërkurën ka takuar në zyrën e vet kryetaren e Partisë së Re Demokratike (NDS) nga komuniteti boshnjak, Emilija

Rexhepi. Takim ka pasur edhe me kryetarin e Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë nga komuniteti serb, Nenad Rashiq, nga të cilët ka marrë përkrahje për formimin e qeverisë së re

KOSOVA DHE BRITANIA PAJTOHEN PËR NJË MARRËVESHJE TË PËRBASHKËT NË FUSHËN E MBROJTJES DHE EKONOMISË

F. 4-5



MISETIÇ: PROVA E SPECIALES KUNDËR HASHIM THAÇIT JANË TË DOBËTA. JAM OPTIMIST DHE DUHET TË KEMI AKTGJYKIMIN SA MË SHPEJT

F. 2



FATURAT DHE TRANSAKSIONET FIKTIVE, TË PAPRANUESHME NGA ATK-ja

F. 8

SPORT



DY GJYQTARET NGA KOSOVA DELEGOHEN NGA UEFA PËR NDESHJE EVROPIANE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Misetiç: Provat e Speciales kundër Hashim Thaçit janë të dobëta. Jam optimist dhe duhet të kemi aktgjykimin sa më shpejt

HAGË, 2 PRILL - Avokati mbrojtës i ish-presidentit Hashim Thaçi, kroat Luka Misiçi, në një intervistë për mediet e Kosovës, ka folur për procesin e gjyimit që po vazhdon tash e gati pesë vjet në Hagë. Misiçi ka thënë se është i zhgënjyer që ish-krerët e UÇK-së po mbahen kaq gjatë në paraburgim, meqë janë katër vjet e gjysmë jetë të cilat s'mund t'i kthesh kurrë mbrapa. "Së pari më lejoni të them se klientët tanë janë mbajtur në paraburgim për një kohë jashtëzakonisht të gjatë, 4 vjet e gjysmë në paraburgim, 4 vjet e gjysmë të cilat nuk mund t'i kthejnë kurrë mbrapa. Jam i zhgënjyer që u deshën 2 vjet e gjysmë që çështja e prokurorisë të përfundonte. Besoj se kjo çështje mund të përfundonte shumë më shpejt, por jemi ku jemi tani", ka thënë Misiçi. Megjithatë, avokati kroat ka thënë se provat e prokurorisë ndaj Hashim Thaçit janë shumë të dobëta dhe Misiçi shpreh optimizëm për epilogun që do të ketë procesi kundër Hashim Thaçit. "Në përgjithësi mendoj se ky

rast dhe provat kundër z. Thaçi kanë qenë shumë të dobëta. Nuk mund të flas për provat tani, por mendoj se në fund të gjyimit do të shihni se pretendimet që nisën me raportin e Martyt nuk kanë thuar asnjë lidhje me provat e paraqitura kundër z. Thaçi në këtë gjykim për mbi dy vjet. Në këtë kuptim jam shumë optimist për rezultatin që del nga ky rast, për z. Thaçi, mendoj se provat kanë qenë shumë të dobëta dhe patjetër se do t'i argumentojmë këto para trupit gjykues në kohën e duhur", ka thënë Misiçi. Ai ka thënë se e vetmja gjë që ka mbetur tani është të shkohet drejt procedurave të tjera të mbetura dhe të merret aktgjykim i sa më shpejt të jetë e mundur. "Siç dihet, nuk mund të jap komente rreth asaj që është thënë në seanca private, nuk mund ta komentoj, por mund t'ju them se nëse flas në përgjithësi, për mendimin tonë, provat kundër z. Thaçi janë jashtëzakonisht të dobëta deri në atë pikë që nganjëherë gjatë procesit e kam pyetur veten 'pse është akuzuar z. Thaçi?'. Do t'i dorëzojmë parashtrirat tona



trupit gjykues në kohën e duhur, por nuk ka shumë gjëra që mund të them për prova specifike të rastit, por jemi të bindur për rezultatin për z. Thaçi dhe e vetmja gjë që ka mbetur tani është të kalojmë nëpër fazat e tjera të procesit sa më shpejt dhe ta kemi aktgjykimin sa më parë të jetë e mundur", ka shtuar tutje ai. Lidhur me dëshmitarët, Misiçi ka thënë se mbrojtja ka dëshmitarë për të cilët mendon se janë tejet efektivë,

megjithatë ka thënë se s'mund të flasë në detaje. "Epo ka dëshmitarë të tillë, disa prej tyre kanë dëshmuar në seanca publike për të cilët mendoj se gjatë kundër pyetjeve kanë qenë dëshmitarë shumë efektivë për mbrojtjen, për z. Thaçi. Sërisht nuk do ta komentoj specifikisht ndonjë dëshmitar tani, edhe po të ishte në seancë publike, sepse do t'i dëgjoni të gjitha këto argumente në kohën e duhur, por mendoj se çështja e cila

është paraqitur nga ana e z. Thaçi në fjalën hyrëse rreth rolit të tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës është vërtetuar përgjatë çështjes së prokurorisë dhe tani neve na ka mbetur vetëm t'i argumentojmë këto para trupit gjykues. Kemi besimin se trupit gjykues e ka të njëjtën përshtypje për këtë rast sikur që e kemi ne dhe do ta presim aktgjykimin. Nëse ka drejtësi këtu, besoj se do të ketë rezultat shumë të mirë për z. Thaçi në fund të krejt kësaj", ka thënë avokati kroat. Ai ka thënë se prokuroria ka dështuar të paraqesë fakte të mjaftueshme në disa pjesë të caktuara të aktakuzës. "Ne do t'i shtrojmë argumentet tona mbi atë se Prokuroria nuk ka arritur të dëshmojë apo të sjellë prova të mjaftueshme për disa pjesë të caktuara të dosjes së tyre. Tani nuk mund të jap detaje sepse nuk është as vendi e as koha e duhur. Do ta bëjmë këtë brenda gjykatores, po besojmë që Prokuroria ka dështuar të paraqesë fakte të mjaftueshme për pjesë të caktuara të aktakuzës", ka deklaruar avokati Luka Misiçi.

Perëndimi do të diskutojë për dislokimin e trupave në Ukrainë, thotë Zelensky

KIEV, 2 PRILL - Udhëheqësit ushtarakë perëndimorë do të diskutojnë për dislokimin e mundshëm të trupave në Ukrainë të cilat do të monitoronin një armëpushim të mundshëm në konfliktin me Rusinë dhe do të ishin pjesë e strukturës së re të sigurisë në vend, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky në videoadresimin e tij të përnatshëm, të martën. "Kjo është pika jonë fillestare: ushtria ukrainase duhet të jetë mjaftueshëm e fortë, dhe mbi këtë bazë duhet të ndërtohet e tërë arkitektura e sigurisë", është shprehur Zelensky më 1 prill. "Brenda pak ditësh - të premten [më 4 prill] - do të mbahet një takim me përfaqësues të shteteve partnere, do të jenë përfaqësues ushtarakë", ka pohuar presidenti ukrainas. Zelensky u takua të martën në Kiev me ministren e Jashtme në largim të Gjermanisë, Annalena Baerbock, dhe tha se "një rreth i ngushtë vendesh" është i gatshëm të dërgojë kontingjente. Udhëheqësi i Ukrainës tha, po ashtu, në një konferencë të

përbashkët për medie me Baerbockun, se po pret përgjigje "më konkrete" nga aleatët rreth gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë në dërgimin e trupave. Franca dhe Britania e Madhe kanë shprehur gatishmërinë për të dërguar trupa, si pjesë e një të ashtuquajturit koalicion të vullnetit, për të monitoruar një armëpushim të mundshëm. Por, Rusia ka kundërshtuar ashpër çfarëdo dislokimi të trupave të huaja në Ukrainë. Në videoadresimin e tij, Zelensky tha, gjithashtu, se Ukraina tashmë ka ndarë me partnerët e saj amerikanë "të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me shkeljet e Rusisë në sektorin e energjisë". Ai shtoi se më 1 prill ka pasur sulme në Herson, përfshirë nga një dron rus, i cili, sipas tij, ka goditur një objekt dhe pajisje energjetike "krejtësisht me qëllim", duke lënë pjesë të qytetit pa rrymë. "Ne ngulmojmë që çdo shkelje e tillë duhet të dokumentohet, dhe kërkojmë të marrim një përgjigje nga partnerët tanë", tha Zelensky. "Janë pikërisht këto detaje të vogla që ndikojnë



në vonesat e mëdha të Rusisë në procesin diplomatik", shtoi ai. Zelensky iu referua një marrëveshjeje ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë për të mos i sulmuar objektet energjetike të njëra-tjetrës. Marrëveshja u njoftua nga Shtëpia e Bardhë, më 25 mars, bashkë me një armëpushim për lejimin e lundrimit në Detin e Zi. Kievi tha se marrëveshja për objektet energjetike do të hynte në fuqi menjëherë. Moska, në

anën tjetër, pohoi se ajo do të zbatohet vetëm pas heqjes së pjesshme të sanksioneve ndaj kompanive dhe bankave ruse, të përfshira në tregtinë ndërkombëtare ushqimore. Gjermania dha, gjatë vizitës së Baerbockut, një zotim për ndarjen e 130 milionë eurove shtesë në formën e ndihmave humanitare dhe të fondeve për stabilizim. Pakoja do ta çojë vlerën e përgjithshme të ndihmave gjermane, që nga fillimi i pushtimit rus të

Ukrainës, në 7 miliardë euro, tha Zelensky. Ai falënderoi Gjermaninë për garancitë se mbështetja e saj për Ukrainën mbetet e parashikueshme dhe sistematike. Stabiliteti i mbështetjes është një prej faktorëve kyçë në mbrojtjen kundër agresionit rus, tha Zelensky. "Janë ndërprerjet e furnizimeve, mosmarrëveshjet ndërmjet partnerëve, dhe të gjitha shenjat e paqëndrueshmërisë tek të cilat po llogarit shumë [presidenti rus, Vladimir] Putin", deklaroi Zelensky. Trupat ruse kryen një sulm masiv me dronë në Harkiv, në natën e 1 prillit. Prefekti Ihor Terekhov tha se 13 dronë Shahed goditën qytetin, me ç'rast u plagosën katër persona. "Pasojat përfshin djegien e dy ndërtesave industriale dhe dëmtimin e më shumë se dhjetë shtëpive private", tha Terekhov. Një sulm i mëhershëm rus, më 1 prill, në rajonin e Zaporizhjes, goditi infrastrukturën civile, duke vrarë një person, bëri me dije guvernatori rajonal Ivan Fedorov.

DY TË DYSHUAR PËR VRASJEN E POLICIT MUHAMED LIKA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Kaçanik, 2 prill - Një pjesëtar i Policisë së Kosovës është vrarë në orët e vona të së martës së 1 prillit në qytetin e Kaçanikut. Policia e Kosovës ka bërë me dije se ai ishte gjetur i plagosur rëndë në hyrjen e ndërtesës ku banonte rreth orës 23:00.

Polici i ndjerë, i cili është identifikuar si Muhamed Lika, ishte transportuar për në Qendrën e Mjekësisë në Kaçanik, por nuk kishte arritur t'u mbijetonte plagëve të pësuar. Rrethanat e ngjarjes, tash për tash, janë të panjohura, ka njoftuar Policia e Kosovës. Autoritetet kanë nisur hetimet për rastin.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, bëri me dije të mërkurën se rreshteri i Policisë së Kosovës, Muhamet Lika, u vra nga dy persona në shkallët e ndërtesës ku banonte teksa po kthehej nga puna, dhe se autorët e dyshuar ndodhen në arrati.

Duke folur në një konferencë për medie në Prishtinë, Çerkini tha se autoritetet janë duke punuar për t'i zbardhur motivet dhe arsyet e vrasjes.

Sindikata e Policisë së Kosovës ka dënuar vrasjen e policit, duke thënë se "ky akt i rëndë është një atentat i drejtpërdrejtë ndaj sigurisë



publike, ligjit dhe shtetit të Kosovës". "Çdo sulm ndaj një zyrtari policor është sulm ndaj Republikës së Kosovës! Policia e Kosovës është shtylla kryesore e rendit dhe sigurisë në vend. Prekja e saj është përpjekje për t'i minuar themelet e shtetit tonë dhe nuk do të tolerohet", thuhet në reagimin e SPK-së.

Për këtë ngjarje tragjike, kryetari i komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, u ka

shprehur ngushëllime familjarëve dhe Policisë së Kosovës. Ilazi në "Facebook" ka theksuar se janë tronditur nga ngjarja e fundit në Kaçanik, ku humbi jetën polici, veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Muhamed Lika. "Të tronditur nga ngjarja e fundit tragjike në Kaçanik, ku humbi jetën polici, veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Muhamed Lika. Me këtë rast



në emër tim dhe të institucioneve komunale, ndajmë ngushëllimet më të sinqerta për familjen, miqtë, kolegët nga Policia e Kosovës dhe gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut e mbarë Kosovës. Lutemi që raste të tilla të mos përsëriten asnjëherë, e shpirti i tij pushoftë i qetë në paqen e paskajme", ka shkruar ai.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se është thellësisht i prekur nga lajmi për vrasjen në rrethana të paqarta të pjesëtarit të Policisë së Kosovës, Muhamed Lika, pranë shtëpisë së tij në Kaçanik. "I ndjeri ishte një atdhetar i dëshmuar, i cili qysh si i ri iu bashkua radhëve të UÇK-së për çlirimin e vendit dhe më pas, në liri, i shërbeu me përkushtim Kosovës nën uniformën e Policisë. Jeta dhe vepra e tij janë shembull i përkushtimit ndaj atdheut dhe mbrojtjes së qytetarëve. Ngushëllimet më të sinqerta familjes Lika, kolegëve të tij në Policinë e Kosovës dhe të gjithë atyre që e njohën. Kërkoj nga institucionet zbardhjen e menjëhershme të këtij rasti dhe sjelljen e autorëve para drejtësisë!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Edhe deputeti i PDK-së, Abelard Tahiri, ka shkruar për vrasjen e policit në Kaçanik. Ai ka thënë se pesë vrasje për vetëm dhjetë ditë ndodhën në Kosovë. "Kjo nuk është vetëm statistikë tragjike, por dëshmi e një kolapsi të thellë të sigurisë publike në Kosovë. Jetët po merren me një lehtësi të frikshme, ndërsa institucionet heshtin. Shteti po dështon në funksionin më elementar të tij - mbrojtjen e qytetarit. Qeveria mban përgjegjësinë direkte për këtë gjendje alarmante. Dështimi për të ndërtuar politika të qëndrueshme të sigurisë, mungesa e kontrollit institucional, dhe toleranca ndaj krimit po i japin Kosovës një realitet ku frika e ka zëvendësuar sigurinë", ka shkruar ai në "Facebook".

Ai ka thënë se nuk mund të kemi as paqe, as drejtësi, as zhvillim, kur qytetari jeton në pasiguri. "Kjo situatë është rezultat i një qeverisjeje të dobët, që nuk po merr përgjegjësi as për jetët që po humbin, as për degradimin e rendit dhe ligjit në vend. Jetët e humbura nuk janë vetëm numra - janë pasoja të drejtpërdrejta të një pushteti që ka harruar qytetarin", ka shkruar Tahiri.



Kosova, mikpritëse e "Defender Europe25"

PRISHTINË, 2 PRILL - Republika e Kosovës përmes Forcës së Sigurisë së Kosovës do të jetë mikpritëse e ushtrimit më të madh ushtarak në Evropë, "Defender Europe 25/Immediate Response".

Lajmin e ka dhënë ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. "Përgatitjet për këtë ushtrim po zhvillohen sipas planit të paraparë dhe jemi të bindur

se realizimi i tij do të jetë i suksesshëm. Sot, në Mnelë të Shqipërisë, së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, vizituam ushtarakët tanë - konkretisht Togun e Mortajave të Regjimentit të Tretë të Këmbësorisë. Kjo njësi po zhvillon stërvitjen e qitjes me mortaja 120 mm, në kuadër të ngritjes së aftësive

luftarake të FSK-së dhe përgatitjeve për ushtrimin 'Defender Europe 2025', ka shkruar ai në "Facebook". Më tutje ka shtuar se aty rikonfirmuan që ushtria jonë është në nivel të atyre të NATO-s për nga përgatitja profesionale, motivi dhe pajisjet në armatim. "Së bashku më të fortë!", ka theksuar Maqedonci.





KOSOVA DHE BRITANIA PAJTOHEN PËR NJË MARRËVESHJE TË PËRBASHKËT NË FUSHËN E MBROJTJES DHE EKONOMISË

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë takimit me sekretarin e jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy, ka propozuar marrëveshje të avancuar strategjike në fushën e mbrojtjes dhe ekonomisë mes dy vendeve, e cila u mirëprit nga sekretari Lammy. Ata gjatë takimit në Prishtinë diskutuan edhe për mbështetjen e palëkundur britanike për sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës, sigurinë rajonale, dialogun me Serbinë, bashkëpunimin ekonomik dhe integrimin euroatlantik

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 2 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka propozuar të mërkurën sekretarit të Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy, lidhjen e një marrëveshjeje për mbrojtje dhe për ekonomi ndërmjet dy vendeve.

Lammy po qëndron për vizitë zyrtare në Kosovë në kuadër të një turneu në Ballkanin Perëndimor që, sipas Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, ka për qëllim kyç forcimin e bashkëpunimit në luftimin e imigracionit të parregullt dhe krimin të rëndë të organizuar.

Osmani ka thënë, në një konferencë të përbashkët për medie me Lammy, se me kryediplomatën britanik ka diskutuar për "thellimin strategjik të bashkëpunimit" ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, i cili, sipas saj, "në veçanti do ta mbulojë fushën e mbrojtjes dhe të ekonomisë".

Presidentja e Kosovës ka bërë me dije se ka diskutuar "gjerë e gjatë" me Lammy, i cili ka mirëpritur idenë e një thellimi bashkëpunimi.

Osmani ka thënë se autoritetet e Kosovës janë të përkushtuara për të punuar me ato britanike për t'i dhënë formë marrëveshjes, që ajo të

nënshkruhet sa më parë.

Po ashtu, ajo ka bërë thirrje për prani edhe më aktive të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.

Lammy ka thënë se Ballkani është rajon që ka rëndësi për Britaninë sot, ashtu siç kishte kur Tony Blair ishte kryeministër. Ai ka shtuar se Britania "do të vazhdojë ta luajë rolin e mikes dhe partneres kyçe" të Kosovës.

Kryediplomati britanik ka thënë se vendi i tij dëshiron një "normalizim të qëndrueshëm e paqësor" ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, teksa ka bërë thirrje që autoritetet e Kosovës të angazhohen me plot energji në dialogun me Serbinë, të

ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Osmani ka thënë se "Kosova mbetet një palë konstruktive, e përkushtuar për paqe dhe stabilitet, pavarësisht se vazhdimisht përballemi me obstrukcione dhe provokime nga ana e Serbisë, përfshirë edhe sulmet e njëpasnjëshme që kanë filluar vite më herët dhe po vazhdojnë edhe tani, për ç'gjë dua ta përmend sërish se është e domosdoshme të ketë llogaridhënie dhe vënie të autorëve para përgjegjësisë nga ana e Serbisë". "Por, fatkeqësisht, po shohim se nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim as sa i përket aktit të agresionit të shtatorit 2023, as sa i përket sulmit ndaj 93 ushtarëve të NATO-s që ka ndodhur edhe më herët, po as edhe veprimeve të fundit terroriste që kanë ndodhur në veri të vendit", është shprehur ajo.

Lammy ka thënë se Britania është kontribuuese e rëndësishme në misionin paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR, i cili, sipas tij, është "absolutisht vendimtar" për sigurinë e Kosovës.

Kurti i flet Lammyt për Radoiqiqin

Të martën mbrëma kryediplomati britanik u prit në Prishtinë nga kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, dhe ministrat e qeverisë së tij. Kurti ka biseduar me Lammy, ndër të tjera, rreth situatës aktuale në rajon dhe asaj gjeopolitike në Evropë, si dhe për çështjet e sigurisë, ka bërë me dije Zyra e Kryeministrit. Kreu në detyrë i ekzekutivit të Kosovës "theksoi faktin që ende nuk ka drejtësi dhe llogaridhënie për sulmin terrorist në Banjskë, teksa Millan Radoiqiq endet i lirë dhe i mbrojtur nga aparati shtetëror serb", thuhet në komunikatën e Kryeministrit.

Në shtator të vitit të kaluar, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë ndaj 45 personave - në mesin e tyre edhe Millan Radoiqiq - për sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë më 24 shtator të vitit 2023, kur kishte mbetur i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku.

Autoritetet në Serbi nuk

KURTI NIS BISEDIMET ME PAKICAT PËR QEVERINË E RE

Kryeministri në detyrë, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, partia e të cilit ka fituar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, ka nisur takimet me partitë politike të pakicave, për t'u konsultuar rreth formimit të qeverisë së re të vendit. Ai të mërkurën ka takuar në zyrën e vet kryetaren e Partisë së Re Demokratike (NDS) nga komuniteti boshnjak, Emilija Rexhepi. Takim ka pasur edhe me kryetarin e Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë nga komuniteti serb, Nenad Rashiq, nga të cilët ka marrë përkrahje për formimin e qeverisë së re

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 PRILL - Kryeministri në detyrë i Kosovës, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, parti e cila i ka fituar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në vend, ka nisur takimet me partitë politike të pakicave për t'u konsultuar rreth formimit të qeverisë së re të vendit. Ky proces ka nisur pas certifikimit të rezulttatit të votimeve dhe fillimit të afateve kushtetuese drejt formimit të legjislaturës dhe qeverisë së re, teksa presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 15 prillin datë për mbajtjen e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës.

Kurti ka bërë me dije se të mërkurën është takuar me kryetaren e Partisë së Re Demokratike (NDS) nga komuniteti boshnjak, njëherësh zëvendëskryeministre në detyrë, Emilija Rexhepi. Sipas një njoftimi nga Zyra e Kryeministrit, Rexhepi “konfirmoi gatishmërinë e plotë për vazhdim të bashkëpunimit” me LV-në dhe mbështetjen e Kurtit në përpjekjet e tij për formimin e qeverisë së re. “Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka filluar takimet me partitë politike të pakicave, për konsultim me to në lidhje me formimin e qeverisë së re pas certifikimit të rezulttatit të zgjedhjeve të 9 shkurtit dhe

fillimit të afateve kushtetuese drejt formimit të legjislaturës dhe qeverisë së re. Në kuadër të këtyre diskutimeve, kryeministri u takua me zëvendëskryeministren e tretë për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut dhe kryetaren e Partia e Re Demokratike (NDS), Emilija Rexhepi. Ajo e konfirmoi gatishmërinë e plotë për vazhdim të bashkëpunimit me Lëvizjen Vetëvendosje! si fituese e zgjedhjeve të fundit dhe mbështetjes së kryeministrit Kurti në formimin e qeverisë së re. Kryeministri Kurti e falënderoi znj. Rexhepi për bashkëpunimin e frytshëm, rezultatet e arritura gjatë këtij mandati dhe punët e mbara që na presin në katërvjeçarin e ardhshëm”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Po të mërkurën Kurti është takuar edhe me kryetarin e Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë nga komuniteti serb, njëherësh ministër në detyrë për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq. “Përgjatë diskutimit, ministri Rashiq e përsëriti mbështetjen e tij ndaj kryeministrit Kurti për formimin e qeverisë së re dhe vazhdimin të bashkëpunimit të frytshëm edhe në mandatin e ardhshëm.

Kryeministri Kurti e falënderoi kryetarin Rashiq për punën e madhe dhe kontributin e dalluar që ka dhënë për komunitetin serb në Kosovë për vetëm gjysmë mandati si ministër për Komunitete dhe Kthim. Ai shprehu gjithashtu vullnetin për vijimin e bashkëpunimit efikas dhe të frytshëm edhe në katërvjeçarin e ardhshëm për të arritur së bashku suksese të tjera dhe punë të mbara në shërbim të të gjithë qytetarëve, pa dallim”, ka njoftuar qeveria. Eugen Cakolli nga Instituti i Kosovës për Demokraci (KDI) ka theksuar se nuk është në rregull dhe as s'duhet të normalizohet që takimet “konsultative” për formimin e qeverisë së re të mbahen në ndërtesën e qeverisë, aq më pak që për to të lëshojë njoftim Zyra e Kryeministrit. “Aq më tepër kur ende nuk ka mandatim zyrtar për formimin e qeverisë, e qeveria aktuale është ‘në detyrë’. Kjo nuk është çështje teknike, por një praktikë që zbeh kufirin mes shtetit dhe partisë, dhe që tregon shumë për mënyrën si konceptohet pushteti. Një subjekt politik që synon të qeverisë vendin duhet të tregojë standarde më të larta - jo t'i shfrytëzojë hapësirat e shtetit

për interesa të veta. Prandaj, takimet konsultative për formimin e qeverisë duhet të mbahen në seli partie ose në ambiente neutrale, kurrësi në zyra publike që u përkasin të gjithë qytetarëve”, ka theksuar Cakolli. LV-ja pretendon se mund t'i sigurojë 61 votat e nevojshme për formimin e qeverisë së re të Kosovës. Ndërkohë dy partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë hedhur poshtë mundësinë e bashkëqeverisjes me LV-në, kurse Partia Demokratike e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate nuk kanë vendosur vija të kuqe për koalicione. Asnjëra nga partitë politike nuk ka mjaftueshëm vota për ta formuar e vetme qeverinë e re. LV-ja, por edhe tri subjektet e tjera politike shqiptare që renditen pas saj, llogarisin në komunitetet joshumicë të cilat kanë dhjetë ulëse të garantuara në Kuvend. Lista Serbe, me nëntë deputetë, nuk është pjesë e përlllogaritjeve të asnjërës prej partive politike shqiptare për një koalicion të mundshëm qeverisës.



pranojnë ta ekstradojnë Radoiçiqin në Kosovë dhe thonë se ai do të gjykohej nga “gjykatat serbe”, ndërsa zyrtarët në Kosovë thonë se ato i kanë ofruar mbrojtje atij. Kurti ka shtuar se Radoiçiqi “duhet të ekstradohet në Kosovë ku do të ballafaqohej me një gjykim të drejtë për veprat e tij”. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës e ka vlerësuar vizitën e Lammyt në vend, duke thënë se ajo “thekson angazhimin e përbashkët për forcimin e lidhjeve mes dy shteteve dhe avancimin e paqes e stabilitetit në rajon dhe më gjerë”. Homologjia e Lammyt, Donika Gërvalla-Schëarz, e ka informuar sekretarin e Jashtëm britanik për, siç është thënë në një komunikatë të MPJD-së, “sfidat e sigurisë në Ballkan, përfshirë veprimet

destabilizuese të Serbisë dhe ndikimin rus, të cilat vazhdojnë ta rrezikojnë stabilitetin rajonal”. MPJD është shprehur më tej se “partneriteti në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar do të vazhdojë të forcohet dhe të thellohet, me fokus në përmirësimin e bashkëpunimit në fushat e sigurisë, ekonomisë dhe politikës ndërkombëtare”. I pranishëm në takimin e Lammyt me kabinetin qeverisës të Kosovës ishte edhe ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves, i cili ka thënë se miqësia në mes të Kosovës dhe Britanisë është e kamotshme dhe e fortë. Sekretari i Jashtëm britanik, pas qëndrimit në Kosovë, pritet ta vizitojë edhe Serbinë, ku është paraparë, sipas qeverisë britanike, nënshkrimi i një marrëveshjeje të bashkëpunimi për luftimin e

Lammy takohet edhe me liderët e partive opozitare

Sekretari i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy, është takuar të mërkurën edhe me liderët e partive opozitare. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se Mbretëria e Bashkuar ka luajtur gjithmonë rol të drejtpërdrejtë në proceset kyçe për Kosovën dhe ne dëshirojmë ta shohim atë të vazhdojë këtë angazhim. “Sekretarin Lammy e informova për vizionin e

Partisë Demokratike të Kosovës për ta marrë përgjegjësinë për formimin e qeverisë së re, nën udhëheqjen e Bedri Hamzës, me objektiva të qarta për zhvillimin ekonomik, rikuperimin dhe forcimin e marrëdhënieve me partnerët strategjikë dhe avancimin e integritimit euroatlantik”, ka njoftuar Krasniqi. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka shkruar për

takimin me Lammyn. “Mbretëria e Bashkuar ka qenë dhe mbetet një nga mbështetëset më të mëdha të Kosovës në të gjitha etapat e saj. Kjo vizitë e nivelit të lartë rikonfirmon këtë përkrahje, në një kohë kur si Kosova, ashtu edhe bota, po përballen me sfida të mëdha”, ka pohuar Haradinaj. Sekretari i jashtëm britanik ka takuar edhe nënkryetaren e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Doarsa Kica-Xhelili.

bandave në qendër të krizës me imigracionin ilegal dhe për sigurimin e kufijve të Mbretërisë së Bashkuar. Mbretëria e Bashkuar do të jetë

mikpritëse e një takimi të udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Samitit të Procesit të Berlinit në Londër në vjeshtën e sivjetme, i

cili, ndër të tjera, ka për qëllim ta mbështesë stabilitetin, sigurinë dhe bashkëpunimin ekonomik mes vendeve të rajonit.


UP-ja hap konkursin për studimet e doktoratës, do të pranohen 51 studentë të rinj

PRISHTINË, 2 PRILL - Universiteti i Prishtinës ka shpallur konkursin për studimet e doktoratës të vitit akademik 2025/'26. Me konkurs është paraparë të pranohen 51 studentë të rinj të doktoratës në 7 programe studimore të 5 fakulteteve. Kandidatët mund të

aplikojnë për studime doktorate në inxhinieri elektrike dhe kompjuterike, mjekësi, edukim, filologji dhe shkencë matematike-natyrore. Për të qenë i vlefshëm aplikimi i tyre në konkurs, këta kandidatë në të dy nivelet e studimeve

baçelor e master duhet ta kenë notën mesatare më të lartë se tetë. Konkursi do të jetë i hapur dy muaj, nga 2 prilli deri më 2 qershor 2025. Universiteti i Prishtinës, më i vjetri, më i madhi dhe më i suksesshmi institucion i arsimit të lartë në

Kosovë dhe i rendituri më së larti në platformat prestigjioze ndërkombëtare nga të gjitha universitetet e hapësirave gjeografike ku jetojnë shqiptarët, është i vetmi universitet në vendin tonë i akredituar për studime doktorate.



NË SHSKUK DISKUTOHET PËR AVANCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E TRAJNIMIT DHE MENAXHIMIT SHËNDETËSOR

PRISHTINË, 2 PRILL - Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka zhvilluar të mërkurën një takim me përfaqësues të Federatës Ndërkombëtare të Spitaleve dhe institucioneve ndërkombëtare të shëndetësisë, me fokus në avancimin e bashkëpunimit dhe rrjetëzimin në fushën e trajnimit dhe menaxhimit shëndetësor. Gjatë takimit, drejtuesit e ShSKUK-së theksuan rëndësinë e rritjes së kapaciteteve



menaxheriale përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare. Po

ashtu, ata shprehën mirënjohje për organizatën IHS për mbështetjen e vazhdueshme

për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore publike në Kosovë. Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimeve strategjike për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve spitalore në vend dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim profesional në menaxhimin shëndetësor. ShSKUK-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar për forcimin e partneriteteve ndërkombëtare për të ofruar shërbime më cilësore për qytetarët e Kosovës.

Në këtë takim morën pjesë Ronald Lavater, kryshefi ekzekutiv i Federatës Ndërkombëtare të Spitaleve, Merita Stavileci dhe Peter Sidler nga Zyra e Korporatës Zvicerane për Zhvillim, si dhe përfaqësues të projekteve IHS dhe AQH, përfshirë dr. Lia Tavadze, dr. Ilir Mecini, Nicu Fota dhe dr. Jana Gerold. Nga ShSKUK-ja të pranishëm ishin drejtori ekzekutiv Elvir Azizi, kryesuesi i Bordit Drejtues, Dren Boshnjaku, drejtorë të klinikave të QKUK-së dhe stafi mbështetës.

NATO-ja PËRFORCON PRANINË NË KOSOVË

PRISHTINË, 2 PRILL - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka njoftuar se në vend janë dislokuar edhe rreth 270 paqeruajtës nga rezervat operacionale të Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Rumanisë. KFOR-i tha se personeli i dislokuar do të operojë në bazë të përkohshme, së bashku me 200 forca rezervë që veçse janë dislokuar në Kosovë nga brigada italiane "Sassari". "Këto përf forcime - së bashku me trupat e KFOR-it - rrisin aftësinë e KFOR-

it për t'iu përgjigjur çdo zhvillimi të rëndësishëm të situatës së sigurisë në përputhje me mandatin që buron nga Kombet e Bashkuara, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së", u tha në njoftim. KFOR-i përsëriti qëndrimin se vazhdon të kontribuojë për një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). KFOR-i është reaguesi i tretë i

sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe EULEX-it. Misioni i NATO-s, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë. KFOR-i ka rritur praninë sa herë që situata ka qenë e tensionuar në Kosovë, sikurse ishte sulmi i armatosur në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit 2023. Kur u dislokua për herë të parë në Kosovë, pas përfundimit të luftës, KFOR-i kishte 50 000 trupa, ndërkaq sot ky numër është afër 4 600 ushtarë.



VENDOSET GURTHEMELI PËR QENDRËN REHABILITUESE DHE ARSIMORE PËR AUTIZMIN, SINDROMËN DOWN DHE PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA



PRISHTINË, 2 PRILL - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Autizmit, në Graçanicë është vendosur gurthemeli i Qendrës për Rehabilitim dhe Arsimim - projekti më i madh i shoqatës humanitare "Jetimat e Ballkanit". Kryetari i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastrati, ka theksuar se sot shënuan fillimin

e një mega projekti. "Sot vendosëm gurthemelin e një ëndrrë të madhe - Qendrës Rehabilituese dhe Arsimore për Autizmin, Sindromën Down dhe Personat me Aftësi të Kufizuara. Në praninë e shumë qytetarëve, donatorëve dhe miqve të shoqatës sonë, me emocione të mëdha dhe gëzim të veçantë,

shënuam fillimin e këtij mega-projekti që do të sjellë dritë dhe shpresë për ata që kanë më së shumti nevojë", ka pohuar ai. Kastrati thotë se ky projekt është një amanet i madh dhe një përgjegjësi e shenjtë për ne. "E lusim Zotin të na lehtësojë këtë rrugëtim dhe të na mundësojë ta realizojmë me sukses këtë vepër

që do t'iu shërbejë brezave! Na priftë e mbara! Me zemër plot mirënjohje, lusim Zotin që të gjithë ata që kontribuuan, po kontribuojnë dhe do të kontribuojnë në këtë vepër të madhe, t'i shpërblejë me mirësi, begati dhe shëndet! Bamiresh, Zoti kurrë mos ju humbë!", ka deklaruar Kastrati.

Presidentja Osmani kujton 26-vjetorin e masakrës në shtëpinë e familjes Vejsa

PRISHTINË, 2 PRILL - 26 vjet më parë në bodrumin e familjes Vejsa ndodhi një nga krimet më të tmerrshme të regjimit gjenocidal të Serbisë. Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar këtë masakër, duke theksuar se 20 gra, fëmijë dhe një burrë janë viktimat të cilat u vranë mizorisht dhe më pas u dogjën, në një akt të pashpirt që synonte të shuante jo vetëm njerëzit, por

edhe kujtesën e tyre. "Por kujtesa nuk shuhet. Emrat e tyre mbeten të gdhendur në historinë e Kosovës si dëshmi e dhimbjes sonë kolektive dhe forcës për të kërkuar drejtësi. Familjet Vejsa, Caka, Haxhiavdija, Nuqi, Hoxha dhe Gashi nuk ishin thjesht viktime të një regjimi kriminal, po dëshmitare të guximit dhe sakrificës që sot frymëzon angazhimin tonë

për të vërtetën dhe drejtësinë. Në këtë përvjetor, ne përkulemi me respekt përpara kujtimit të tyre dhe ripërsërisim thirrjen tonë: Secili që urdhëroi dhe kreu këto krime duhet të ndëshkohet. Dhembja mbetet, por bashkë me të edhe përkushtimi ynë që këto krime të mos harrohen kurrë. Lavdi kujtimit të tyre!", ka thënë Osmani.



ARRESTOHEN 12 AKTIVISTË NË PROTESTËN KUNDËR SHTRENJTIMIT TË RRYMËS NË KOSOVË

Zyrtarë të Policisë së Kosovës arrestuan të mërkurën 12 aktivistë që protestuan para zyrave të ZRrE-së kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike prej së paku 15-përqindësh, e që është e papranueshme dhe e papërbalueshme për pjesën më të madhe të qytetarëve të Kosovës. Pas disa orësh këta aktivistë janë liruar.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 PRILL - Një protestë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike në Kosovë, para Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE), e cila pritet të vendosë rreth një propozimi për ngritjen e çmimit të rrymës në vend, ka përfunduar me arrestimin e disa personave në mëngjesin e së mërkurës, ku ata pas disa orësh janë liruar.

Aktivistë kundër shtrenjtimit të rrymës, nga iniciativa "Asnji Cent Ma Shumë!", bllokuan zyrat e ZRrE-së në lagjen Lakrishte në Prishtinë para se të prangoseshin nga Policia e Kosovës.

Dymbëdhjetë prej protestuesve janë arrestuar. "Aktualisht, të njëjtit janë duke u proceduar konform autorizimeve policore në koordinim me prokurorin e shtetit", ka njoftuar Policia.

Të arrestuarit, të cilët, sipas policisë, kanë zhvilluar aktivitet të paparalajmëruar, "kanë shpërfillur urdhrat e zyrtarëve policorë dhe kanë penguar disa zyrtarë të hyjnë në zyrat e tyre". ZRrE-ja ka paralajmëruar se nga muaji prill faturat e energjisë elektrike mund të rriten për 15 për qind.

Aktualisht për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi

i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat. Në rast të shtrenjtimit për 15 %, ata do të paguanin 8.96 centë.

ZRrE-ja i shqyrton dhe cakton tarifatat e energjisë elektrike çdo vit dhe ato janë në fuqi nga 1 prilli deri më 31 mars të vitit pasues.

KMDLNj-ja kundërshton arrestimin e aktivistëve para ZRrE-së

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ka kundërshtuar arrestimin e aktivistëve para ZRrE-së. "KMDLNj e përkujton opinionin se kjo është rritja e tretë e çmimit të rrymës gjatë mandatit 4-vjeçar të qeverisë Kurti 2 që nënkupton se rritja e tretë e çmimit të rrymës e kompletton shifrën prej 146 për qind. KMDLNj e përkujton opinionin se ZRrE në afatin 15-vjeçar ka vjedhur qytetarët e Kosovës duke ua fryrë faturat për të kompensuar shpenzimin e rrymës nga ana e serbëve gjë që e ka konstatuar edhe gjykata kompetente duke marrë vendim që të kompensohen e që ZRrE nuk e ka bërë. ZRrE ka diskriminuar qytetarët e Kosovës ekskluzivisht në baza etnike që është në kundërshtim



të plotë me ligjet në fuqi dhe Kushtetutës së Kosovës. Qeveritë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të mbrojtur qytetarët por janë rreshtuar pas një institucioni diskriminues dhe shkelësi i të drejtave të njeriut që është ZRrE. Propozimin e fundit për rritje të çmimit të rrymës e kanë kundërshtuar të gjitha institucionet, qytetarët, shoqëria civile, bizneset, odat ekonomike dhe mediat", thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Sipas këtij reagimi, Qeveria e Kosovës ka dalë me një propozim mashtrues dhe diskriminues duke përkrahur rritjen e çmimit të energjisë elektrike për qytetarët që shpenzojnë mbi 800 Kw në muaj që rëndë e shkelë parimin kushtetues për trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të qytetarëve e që është në kundërshtim të plotë me

dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. KMDLNj fton qytetarët e Kosovës të dalin në numër sa më të madh në protestën e paralajmëruar më 5 prill 2025 për ta kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe për të kërkuar përgjegjësi për vjedhje 15-vjeçare që ua ka bërë ZRrE-ja si dhe për moskompensim të dëmit të bërë.

KMDLNj ka theksuar se e përkrah çdo protestë paqësore sikur që ishte protesta e sotme duke kërkuar që protesta të valëzohet në tërë Kosovën, në mbrojtje të standardit edhe ashtu të mjerë të shumicës së qytetarëve të Kosovës. "KMDLNj fton Policinë e Kosovës që të mos instrumentalizohet nga politika dhe të mos pengojë protestat paqësore, si njërën ndër të

drejtat elementare të njeriut. KMDLNj paralajmëron opinionin se rritja e çmimit të energjisë elektrike do të prodhojë efekte zinxhirore duke rritur çmimet e të gjithë artikujve tjerë dhe shërbimeve. Dilni sa më shumë në protesta, mos iu jepni ngjyrimet politike dhe mos bini nën ndikime politike por protestoni ekskluzivisht kundër rrezikimit flagrant të standardit duke kërkuar në të njëjtën kohë indeksimin e çmimeve dhe rritjen e pagave, pensione, asistencës sociale si kusht për ta përbaluar inflacionin. Kërkoni të hiqet taksa fikse prej 2 eurosh për çdo njeësorë në Kosovë dhe kërkoni përgjegjësi për këtë. KMDLNj kërkon lirimin e të arrestuarve dhe arrestimin e përgjegjësve konkret e që janë brenda ZRrE-së dhe Ministrisë përkatëse", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

NËSE LV-ja NUK ARRIN SHUMICËN, PDK-ja E GATSHME TA FORMOJË QEVERINË ME BEDRI HAMZËN

PRISHTINË, 2 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt të Kryesisë, në të cilën është diskutuar për zhvillimet politike në vend pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, si dhe për hapat e ardhshëm pas caktimit të datës së konstituimit të Kuvendit nga presidentja e republikës më 15 prill.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i informoi anëtarët e Kryesisë për komunikimet e fundit me partitë parlamentare, me përjashtim të partive në pushtet (LV, Guxo dhe Alternativa). Ai theksoi se, nëse partia që ka dalë e para në zgjedhje nuk arrin ta formojë shumicën e nevojshme, PDK-ja është e gatshme ta marrë përgjegjësinë e saj për formimin e qeverisë së re, me Bedri Hamzën në krye të ekzekutivit. Në këtë proces u tha se PDK-ja do të veprojë në përputhje të



plotë me Kushtetutën dhe parimet demokratike, pa ndërmarrë asnjë veprim bllokues apo përpjekje që do ta cenonte funksionimin institucional në seancën

konstitutive. "Ne kemi objektiva të qarta për zhvillimin ekonomik, rikuperimin dhe forcimin e marrëdhënieve me partnerët tanë strategjikë, si dhe avancimin e procesit të

integritetit euroatlantik. PDK-ja ka kapacitetin dhe vizionin për ta çuar Kosovën përpara", ka thënë kryetari Krasniqi. E kandidati për kryeministër nga PDK-ja, Bedri Hamza, ritheksoi

përkushtimin për ta jetësuar vizionin për një Kosovë më të zhvilluar dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e saj.

Në përfundim të mbledhjes, Partia Demokratike e Kosovës shprehu qëndrimin se vendi duhet të ketë sa më parë institucionet e reja, në mënyrë që të adresohen çështjet kyçe për qytetarët dhe të ecet përpara për përmbushjen e prioritetëve shtetërore.

Para mbledhjes së Kryesisë, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka takuar të mërkurën të gjithë deputetët e zgjedhur të PDK-së në një drekë pune.

Gjatë takimit ata kanë diskutuar në mënyrë të hollësishme për përgatitjet dhe qëndrimet e partisë në lidhje me seancën konstitutive të 15 prillit, duke u fokusuar në hapat e ardhshëm dhe prioritetet e grupit parlamentar.

Pasuria e linjtit, shtylla e sigurisë energjetike të Kosovës



Shkruan: Ethem ÇEKU

“Ne i kemi dhënë fund luftës kundër energjisë amerikane - dhe i kemi dhënë fund luftës kundër qymyrit të bukur e të pastër”, deklaroi presidenti Donald Trump, duke mbështetur fuqishëm prodhimin e energjisë nga linjiti. Kjo deklaratë e fuqishme nga kreu i shtetit më të fuqishëm në botë pasqyron një realitet të thjeshtë: edhe në shekullin XXI qymyri (veçanërisht linjiti) vazhdon të luajë rol vendimtar në sigurimin e energjisë për shumë vende. Për Kosovën, e cila zotëron pasuri të jashtëzakonshme të këtij burimi, ky mesazh tingëllon veçanërisht domethënës. Kosova renditet ndër vendet më të pasura në botë sa iu përket rezervave të linjtit - rreth 11 miliardë tonë të kësaj lënde djegëse fosile prehen nën tokën e saj. Këto rezerva kolosale përfaqësojnë një potencial strategjik unik për vendin tonë. Prej dekadash, linjiti ka qenë shtylla kurrizore e prodhimit vendas të energjisë elektrike, duke siguruar afro 90 % të furnizimit. Megjithatë,

pavarësisht këtij bollëku natyror, Kosovës i është dashur shpesh të përballet me mungesa të energjisë dhe importe të shtrenjta, kryesisht për shkak të pamundësisë për ta shfrytëzuar plotësisht këtë pasuri. Pra, paradoksalisht, pasuria jonë energjetike mbetet ende nëntokë, ndërsa ne vazhdojmë të blejmë rrymë nga jashtë. Në këtë kontekst, projekti “Kosova C e ri dizajnuar me 1 mijë megawat” shihet si një domosdoshmëri e ngutshme për sigurimin energjetik të vendit dhe një hap i guximshëm drejt shfrytëzimit efikas të resurseve tona. Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e energjisë prodhohet nga termocentralet e vjetra “Kosova A” dhe “Kosova B”. Këto blloqe, sidomos ato të bllokut A, janë tejkaluar teknologjikisht dhe ekologjikisht - ato kanë efikasitet të ulët, emetojnë nivele të larta ndotjesh në ajër dhe shpesh kanë defekte apo ndërprerje. “Kosova C” do të sillte zëvendësimin e këtyre kapaciteteve të amortizuara me blloqe të reja, më moderne dhe më të fuqishme. Një termocentral i ri, i ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore, jo vetëm që do ta rriste prodhimin e brendshëm dhe do të garantonte furnizim të qëndrueshëm 24/7, por edhe do ta përmirësonte ndjeshëm performancën mjedisore në krahasim me gjendjen aktuale.

Për më tepër, kërkesa globale për energji pritët të rritet nga 8 deri në 20 për qind në vitet e ardhshme, si pasojë e zgjerimit të përdorimit të inteligjencës artificiale dhe teknologjive të avancuara - një tjetër arsye që Kosova të mos mbetet prapa në kapacitetet e veta prodhuese. Është e rëndësishme të theksohet se një termocentral i ri me teknologji moderne do të reduktojë emetimet e CO₂ dhe ndotësve të tjerë krahasuar me termocentralet ekzistuese. Pajisjet e reja do të kenë efikasitet më të lartë djegieje, çka nënkupton më shumë energji të prodhuar nga e njëjta sasi linjiti dhe, për rrjedhojë, më pak gazra serrë të lëshuar për çdo megavat orë. Po ashtu, filtrat dhe teknologjitë e sotme mund të kapin një pjesë të madhe të pluhurit dhe gazeve të dëmshme, duke e bërë prodhimin e energjisë më të pastër se më parë. Duke ndërtuar “Kosova C”, vendi ynë do të kishte mundësinë të mbyllte gradualisht blloqet më ndotëse të “Kosova A”, gjë që do të ulte ndotjen e përgjithshme në ambient. Njëkohësisht, rritja e prodhimit vendas do të thotë ndalim i importeve të shtrenjta të rrymës elektrike: paratë që sot derdhen jashtë shtetit për të blerë energji do të mbeteshin në ekonominë vendase, ndërsa qytetarët dhe bizneset do të gëzonin furnizim më të sigurt dhe me kosto më të ulët afatgjatë.

Shtetet më të zhvilluara në botë nuk kanë hequr dorë nga qymyri, veçanërisht nga linjiti, përkundrazi - ata po i modernizojnë kapacitetet e tyre. SHBA, pavarësisht zhvillimeve në gazin natyror dhe energjinë diellore, ende përdor qymyr për një pjesë të konsiderueshme të energjisë. Gjermania, pas mbylljes së centraleve bërthamore, ka mbështetur më shumë përdorimin e linjtit për siguri energjetike. Polonia, Turqia dhe India janë ndër përdoruesit më të mëdhenj të qymyrit në botë. Në rajonin tonë, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Greqia mbështeten ndjeshëm në termocentrale me bazë linjiti. Kosova nuk është përjashtim - ajo duhet të veprojë njësoj si kombet që kanë siguruar stabilitetin ekonomik dhe energjetik përmes burimeve të veta. Projekti “Kosova C” nuk është vetëm një investim në energji - është një investim në zhvillim ekonomik, në punësim dhe në të ardhmen e gjeneratave të reja. Ndërtimi i termocentralit do të gjeneronte mijëra vende pune që nga faza e parë e ndërtimit, duke përfshirë inxhinierë, teknikë, punëtorë dhe furnitorë lokalë. Pas përfundimit, qindra të tjerë do të punësohen në operim dhe mirëmbajtje. Investimi do të rrisë ndjeshëm aktivitetin ekonomik vendor, do të ulë papunësinë dhe do të forcojë buxhetin e shtetit nëpërmjet

tatimeve dhe eksportit potencial të energjisë. Për më tepër, një furnizim i qëndrueshëm energjie është parakusht për tërheqjen e investimeve të huaja dhe rritjen e prodhimit vendor. Për të realizuar këtë projekt jetik për të ardhmen e Kosovës, është thelbësore që institucionet tona të kërkojnë partneritet strategjik me aleatët tanë kryesorë - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermaninë. Këto shtete jo vetëm që kanë përvojën dhe teknologjinë më të avancuar për ndërtimin e kapaciteteve moderne energjetike, por kanë treguar vazhdimisht mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë e Kosovës. Një projekt i tillë do të duhej të përfshihej në partneritete publike-private me kompani serioze ndërkombëtare dhe me garanci për transparencë, efikasitet dhe përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët tanë. Kosova ka pasuri - por ka nevojë për vendime të guximshme dhe vizion të qartë. Është koha që linjiti, krahas energjisë diellore, të mos mbetet vetëm një statistikë nëntokësore, por të shndërrohet në një motor zhvillimi, pavarësie dhe stabiliteti për vendin tonë. “Kosova C” është shumë më tepër se një termocentral - është garancia që do të jetojmë si të barabartë me kombet e tjera të botës.

Faturat dhe transaksionet fiktive, të papranueshme nga ATK-ja

PRISHTINË, 2 PRILL - Administrata Tatimore e Kosovës ua rikujton të gjitha bizneseve të cilat merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor, ATK-ja nuk i njeh transaksionet e realizuara me bizneset fiktive dhe bizneset joaktive. “Transaksionet e realizuara me bizneset fiktive dhe bizneset joaktive, gjegjësisht shpenzimet në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, si dhe kërkesat për kreditim të zbritshëm në një deklaratë të TVSh-së, nuk do të njihen nga ATK-ja. Njëherësh, ATK-ja ju njofton se aktivitetet e saj do të përqendrohen te bizneset të cilat zhvillojnë transaksione fiktive dhe te bizneset joaktive që funksionojnë në mënyrë jo të rregullt, për të cilat do të ndërmerren masat e përcaktuara me legjislacionin tatimor”, ka njoftuar ATK-ja. Administrata Tatimore e Kosovës u bënë thirrje të gjitha bizneseve, që para se të hyjnë në transaksione afariste, të bëjnë verifikimin e bizneseve joaktive të cilat i gjeni në ueb faqen:atk-ks.org. “Çdoherë kur ATK-ja gjatë verifikimit të dokumentacionit identifikon



ndonjë transaksion/faturë fiktive, pavarësisht se a është biznesi që ka lidhur transaksionin/lëshuar faturën i publikuar në uebfaqe të ATK-së apo jo, ai transaksion / ajo faturë nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së shpenzimeve në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, si dhe

nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së TVSH-së së zbritshme. Po ashtu, për të dy bizneset, si për biznesin i cili e ka lëshuar faturën për transaksionin fiktiv, ashtu edhe për biznesin që e ka pranuar faturën për transaksionin fiktiv, ATK-ja do të ndër marrë masat e

përcaktuara me Legjislacionin në fuqi”, ka njoftuar ky institucion. Sipas ATK-së, është detyrë e çdo tatimpaguesi t’i respektojë dhe t’i zbatojë dispozitat e legjislacionit tatimor të aplikueshëm. “Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju kontribuoni direkt në ofrimin

e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore”, ka theksuar ATK-ja.

MARINE DHE PARTIA E MALLKUAR QË KA TRANSFORMUAR FRANCËN

Ajo kishte arritur të çlirohej nga trashëgimia e të atit dhe të normalizonte Frontin. Në krye të sondazheve, pa të ndryshon e ardhmja e vendit



Marine Le Pen trashëgoi nga babai një parti të mallkuar dhe e shndërroi në kundërshtarin për t'u mposhtur, pothuajse në pikë referimi të jetës politike franceze. Pasi u mposhtën partitë historike dhe tradicionale, socialistët dhe golistët, vetëm Emmanuel Macron, me shpikjen e një lëvizjeje as të djathtë as të majtë, i bëri ballë rritjes së ekstremit të djathtë të ish-Frontit Nacional. Sipas sondazhit të fundit, të publikuar të dielën nga "Journal du dimanche", ajo shfaqej gjerësisht në krye të preferencave për vitin 2027, kur Macroni nuk do të mund të rikandidojë: 34–37 për qind. Kundërshtarët më të afërt rezultojnë dy ish-kryeministra, Édouard Philippe dhe Gabriel Attal, me 25 dhe 20 për qind. Kjo nuk do të thotë aspak se zgjedhja ishte e paracaktuar, sepse ai mund të ishte rezultati i raundit të parë, ku garojnë disa kandidatë. Por pastaj vjen balotazhi, dhe

për dy herë Macroni e ka mundur atë: 66 me 33 në 2017 dhe 59 me 41 në 2022. Megjithatë, ajo ka qenë gjithmonë në rritje me një përparim që dukej i pandalshëm – deri dje – duke u bërë kandidatja më e fortë. Ky është rezultati i më shumë se njëzet vite "lepenizimi" të mendësive, siç thuhej me përçmim kur ishte ende gjallë Jean-Marie Le Pen, udhëheqësi i papranueshëm i Francës së errët, i njohur si "Menhiri" apo "Djalli i Republikës". Ajo lëvizi drejt normalizimit, dhe populli i zhgënjyer nga e majta dhe përgjithësisht nga politika u afrua drejt saj, duke e kthyer lëvizjen e Marine në partinë e parë. Ndoshta nuk do ta dimë kurrë nëse më shumë se gjysma e francezëve do të kishin votuar me të vërtetë për Marine si presidente të Republikës, duke e ulur në atë fron monumental të krijuar gjashtëdhjetë vite më parë nga de Gaulle, me aurën e njeriut që kishte shpëtuar Francën

nga disfata e nazistëve. Dënimi i shpallur dje nga Gjykata e Parisit bie si një gijotinë mbi ambiciet e Marine, e cila, edhe pse nuk i ka mbushur ende gjashtëdhjetë vjet, mund të shpresojë përtej pesë viteve. Por me vendimin e djeshëm, përveç nëse ndodh ndonjë përmbysje e bujshme në apel, përfundon për të një ndjekje që kishte nisur në vitin 2011, kur ajo e trashëgoi partinë nga babai në mënyrë të drejtpërdrejtë. Si një monarki, ose më keq, një autokraci vetëlegjitimuese, e drejtuar nga një klan familjar ku ajo është udhëheqësja absolute, dhe ku bëjnë pjesë motrat, Caroline dhe Yann (edhe ajo e dënuar me një vit), nëna e Marion Maréchal, deputete europiane dhe një tjetër figurë e njohur e partisë, përveç një grupi të afërmish, të gjithë të lidhur ngushtë me Jean-Marie-në e vjetër. Edhe pse që prej më shumë se një viti në krye të partisë është vendosur përmes një kongresi

farsë i riu Jordan Bardella, është e qartë për të gjithë se pa Le Pen, Rassemblement National nuk ekziston. Vetë ajo e pranoi së fundmi se nëse nuk do të ishte kandidate, do t'i takonte sërish asaj të zgjidhte personin e duhur. Ka edhe diçka paradoksale dhe groteske në këtë dënim. Normalizimi i partisë që në Francë është quajtur "dédiabolisation" – si një ekzorçizëm i kryer nga vajza për t'u çliruar nga fantazma e të atit – është kthyer kundër saj. Në leximin e vendimit, kryetarja e gjykatës, Bénédicte de Porthuis, përmendi pikërisht Jean-Marie-në si shpikësin e sistemit të çoroditur dhe të paligjshëm të financimit të partisë që nga viti 2004 dhe që Marine e ka vazhduar me "autoritet dhe vendosmëri". Bëhet fjalë për gati tre milionë euro, mbi 470 mijë për përfitime personale, jo për pasurim vetjak, por për "pasurimin e partisë". Jordan Bardella nuk ka as emrin dhe as karizmën e

mjaftueshme. Në fakt, megjithëse është një figurë e re, tejet i dukshëm në media, i zgjuar dhe elokuent, ai mbetet një krijesë politike e formuar dhe e mbikëqyrur nga vetë Marine. Ai nuk ka historinë, rrënjët familjare, as përvojën për ta mbajtur të bashkuar një lëvizje që ka funksionuar për vite me radhë mbi bazën e një lideri të vetëm, autoritar dhe karizmatik. Me këtë dënim, asgjë nuk është përfundimtare — sepse ekziston ende rruga e apelimit — por padyshim që vizioni i një Marine Le Pen presidente në vitin 2027 është më i largët se kurrë. Dhe me largimin e saj të mundshëm nga skena, e gjithë dinamika politike franceze ndryshon rrënjësisht. Përballë një të djathte radikale që nuk ka më një figurë udhëheqëse të fuqishme, dhe një presidenti në largim pa trashëgimtar të qartë, e ardhmja e Francës mbetet e paqartë dhe e hapur për zhvillime të papritura. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit



Dy gjyqtaret nga Kosova delegohen nga UEFA për ndeshje evropiane

PRISHTINË, 2 PRILL - Shtëpia më e madhe e futbollit evropian UEFA vazhdon t'u besojë gjyqtarëve nga

Kosova. Kësisoj dy gjyqtaret nga Kosova, Rita Vehapi dhe Fitore Govori, do ta ndajnë drejtësinë në arenën

ndërkombëtare. Rita Vehapi (gjyqtare kryesore) dhe Fitore Govori (asistente) janë deleguar nga UEFA për

ndeshjet në UEFA Women's Under-19 Championship 2025, raundi i dytë - grupi B6.

Drenica e rikthen Bylbyl Sokolin trajner

SKENDERAJ, 2 PRILL - Klubi i Futbollit Drenica e ka rikthyer Bylbyl Sokolin kryetrajner të skuadrës. Lajmin e ka dhënë Klubi nga Skenderaj, duke theksuar se i beson vizionit të Sokolit për futjen e Drenicës në Superligë. "Pas ndryshimeve në stafin drejtues, klubi ka arritur marrëveshje me

trajnerin e ri që do ta udhëheqë ekipin në pjesën e mbetur të sezonit. Bylbyl Sokoli, trajneri me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, zyrtarisht është emëruar kryetrajner i ri i skuadrës. Me një histori të pasur në zhvillimin e futbollit dhe drejtimin e skuadrave të njohura, besojmë se përvoja

dhe vizioni i Sokolit do të jenë vendimtare për ta ndihmuar klubin t'i arrijë objektivat", ka njoftuar FC Drenica. Emërimi i trajnerit të ri vjen pas largimit të Arsim Thaqit, i cili e kishte zëvendësuar pikërisht Bylbyl Sokolin, i cili ishte larguar nga ekipi pasi i kishte hyrë garës për deputet nga radhët e Vetëvendosjes.



Struga - Shkëndija, finale para finales në Kupën e Maqedonisë

SHKUP, 2 PRILL - Në ambientet e Federatës së Futbollit të Maqedonisë të mërkurën është hedhur shorti për fazën gjysmëfinale të Kupës së Maqedonisë së Veriut për këtë sezon. Katër skuadra, Shkëndija, Struga Trim & Lum, Vardari dhe AP Brera, do të luftojnë për një vend në finalen e madhe. Shorti ka rezervuar një duel të veçantë, ku kampionët në fuqi të Maqedonisë, Struga Trim & Lum, do të përballen me lideren aktuale, Shkëndijën e Tetovës.



Ky takim premtan spektakël, pasi të dyja skuadrat janë ndër më të fortat në këtë edicion. Në gjysmëfinalen tjetër, Vardari ka pasur fatin më të madh në short, duke u përballur me ekipin e AP Brera, e cila konsiderohet kundërshtarja më e lehtë e kësaj faze. Kjo fazë do të zhvillohet me dy ndeshje, ku secila skuadër do të ketë mundësinë të luajë në fushën e saj. Sfidat e parë është planifikuar të luhet më 9 prill. Nga katër ekipet gjysmëfinaliste, vetëm Struga

ende nuk e ka fituar trofeun e Kupës, ndërsa më i suksesshmi në këtë garë mbetet Vardari, me pesë tituj. Megjithatë, ekipi nga Shkupi nuk e ka fituar këtë titull që prej vitit 2007. Përballja në mes të Strugës dhe Shkëndijës pritet të jetë më e nxehta e kësaj faze, duke parë formën e lartë të dy skuadrave. A do të vazhdojë dominimi i kuqezinjve të Tetovës, apo Struga do ta shkruajë historinë në këtë garë, mbetet të mësohet pas dy dueleve gjysmëfinale.

Ancelotti del në gjyq për evazion fiskal, prokurori kërkon rreth pesë vjet burgim dhe mbi tre milionë euro gjobë

MADRID, 2 PRILL - Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka dalë të mërkurën para gjykatës. Ai akuzohet se nuk ka paguar një milion euro tatim mbi të ardhurat nga të drejtat e imazhit gjatë periudhës së tij të parë në klubin mbretëror. Italiani Ancelotti është i fundit nga disa personazhe të famshëm të futbollit që do të

hetohen nga autoriteti tatimor spanjoll për mashtrim të dyshuar tatimor. Shumë raste, përfshirë ato të lojtarëve kryesorë si Cristiano Ronaldo i Portugalisë dhe Diego Costa i Spanjës, janë zgjidhur jashtë gjykatës me gjoba të mëdha. Prokurori ka kërkuar që Ancelotti të dënohet prej katër



vjet e nëntë muaj burgim dhe një gjobë prej 3.2 milionë

eurosh për dy akuza për evazion fiskal në vitet 2014 dhe 2015. Konkretisht Ancelotti akuzohet se ka mashtruar thesarin publik 1 062 079 euro në vitet fiskale 2014 (386 361 euro) dhe 2015 (675 718 euro) gjatë periudhës së tij të parë si trajner i Real Madridit. Ai ka argumentuar se Ancelotti

kishte raportuar vetëm pagën që i paguhej nga Real Madridi dhe kishte hequr të ardhurat nga të drejtat e tij të imazhit në deklaratat e tij tatimore. Ancelotti u ka thënë gazetarëve javën e kaluar se kishte besim të plotë në sistemin spanjoll të drejtësisë dhe se mezi priste të dëshmonte në gjykatë.

Bundesliga vendos të hapë një merkato ekstra për Kupën e Botës për Klube

BERLIN, 2 PRILL - Federata Gjermane e Futbollit (DFL) ka njoftuar se Bundesliga dhe Bundesliga 2 do të kenë një merkato shtesë transferimesh nga 1 deri më 10 qershor përpara fillimit të Kupës së Botës për Klube të FIFA-s. Kjo masë vjen si rezultat i një vendimi të FIFA-s, e cila u ka dhënë federatave të vendeve

pjesëmarrëse në turne, mundësinë e hapjes së një "dritareje të jashtëzakonshme regjistrimi" gjatë qershorit për t'i lejuar klubet të bëjnë përf forcime. Kupa e Botës për Klube 2025, e cila për herë të parë do të zhvillohet me 32 skuadra, do të mbahet në Shtetet e Bashkuara nga 14 qershori

deri më 13 korrik. Dy ekipet e Bundesligës, Borussia Dortmund dhe Bayern Munich, do ta përfaqësojnë Gjermaninë në këtë kompeticion. Kjo merkato e veçantë e transferimeve mund t'i ndihmojë këto skuadra të bëjnë përmirësime strategjike përpara turneut, duke pasur mundësinë të

nënshkruajnë me lojtarë të rinj përpara fillimit të sezonit të ri. Me kalendarin e ngjeshur dhe sfidën e fortë në Kupën e Botës për Klube, Dortmundi dhe Bayerni mund të shfrytëzojnë këtë periudhë për ta rritur cilësinë e skuadrave të tyre. Ky turne do të jetë një mundësi e madhe për klubet evropiane



të përballen me kundërshtarë nga të gjitha kontinentet, duke e bërë edicionin e parë të këtij formati një spektakël të vërtetë futbollit.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli:	Zyrtar/e i/e lartë për mbikëqyrje dhe analiza të sistemeve të pagesave
Grada:	P05
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Sistemi i Pagesave
Divizioni:	Mbikëqyrjes dhe Analizave të sistemeve të pagesave
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Vlerëson, analizon dhe mbikëqyrë sistemin e pagesave si tërësi, instrumentet individuale dhe mënyrat e reja të pagesave elektronike të përdorura në kuadër të sistemit të pagesave në vend;
- Kontribuon në hartimin e politikave, rregullave dhe procedurave/manualeve për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave, në pajtim me standardet ndërkombëtare, me fokus parimet e BIS/CPSS për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave;
- Realizon vlerësimin e sistemit të pagesave në pajtim me rregullat e mbikëqyrjes dhe kryen monitorimin e pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregullativën në fuqi që të sigurojë që sistemet e pagesave funksionojnë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe efektive;
- Vlerëson sistemin e pagesave dhe përgatit analiza të rreziqeve, përfshirë rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional, rrezikun kreditor, rrezikun ligjor dhe rrezikun sistematik të sistemit të pagesave;
- Siguron që sistemet garantojnë shkallë të lartë sigurie dhe besueshmërie operationale, si dhe që sistemet e pagesave të kenë procedura për vazhdimësinë e punës në raste të jashtëzakonshme;
- Kontribuon, në bashkëpunim me departamentin e licencimit, në vlerësimin e kërkesave të reja për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve dhe operatorëve të pagesave, të kliringut dhe shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe shërbimeve tjera të pagesave;
- Kontribuon në rishikimin dhe plotësimin e strategjisë për zhvillimin e sistemit kombëtar të pagesave;
- Kontribuon në përgatitjen dhe plotësimin e raportit të progresit nga Komisioni Evropian dhe raporte tjera nga organizatat ndërkombëtare;
- Realizon vlerësimin e infrastrukturës teknike dhe ligjore të pjesëmarrësve të ri në sistem;
- Kontribuon në projektet hulumtuese që ndikojnë në zvogëlimin e parasë së gatshme në qarkullimin dhe iniciimin dhe promovimin e pagesave elektronike;
- Udhëheqë dhe angazhohet në inspektimet e bankave dhe institucionet tjera financiare që ofrojnë shërbimin e pagesave, si dhe operatorëve tjerë të mundshëm të sistemeve të pagesave;
- Komunikon dhe koordinohet me Departamentet dhe Divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin, për mbarëvajtjen e mbikëqyrjes të operatoreve të pagesave individualisht dhe të sistemit në tërësi;
- Në pajtim me standardet e BE-së, analizon mundësitë e përshtatjeve të reja në infrastrukturë teknike dhe ligjore për funksionim më efikas të sistemit të pagesave dhe rekomandon lidhur me mundësitë për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të pagesave;
- Trajnon dhe udhëzon stafin e ri të divizionit lidhur me ndryshimet/plotësimet e reja të kornizës ligjore dhe rregullative dhe aplikimin e metodologjive të reja mbikëqyrëse dhe analitike;
- Ndihmon Udhëheqësin e Divizionit/Drejtorin në komunikimet dhe takimet me palët e jashtme (institucionet financiare, operatorët / mediat) dhe palët e brendshme (departamentet/divizionet) në BQK;
- Kontribuon në zhvillimin e planit vjetor dhe raportit vjetor të departamentit dhe në përgatitjen e vlerësimit dhe planit zhvillimor individual për zyrtarët e nivelit më të ulët;
- Sipas nevojë, realizon punë të tjera të lidhura me mbikëqyrjen e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave në kuadër DSP-së, të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësiëve të përgjithshme të punës.

Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave të ekonomisë (drejtimet menaxhment dhe informatikë apo banka dhe financa) ose shkencave juridike;
- Përvojë prej së paku tre (3) viteve të ndërlidhur me kornizën rregullative dhe standardet në Kosovë dhe BE për shërbimet e pagesave, apo instrumentet/shërbimet tjera financiare të ndërlidhura;
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë dhe njohuri në vlerësimin e proceseve që kërkojnë përgatitjen e raporteve analitike/statistikore, si dhe aplikimin e standardeve për shërbime të pagesave, me preferencë përvoja në sektorin bankar
- Shkathësi organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve dhe adaptim të shpejt me zhvillimet e reja;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të avancuara të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Të ketë njohuri të mirë të gjuhës angleze.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **18 prill 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv:	Viši službenik za nadzor i analizu platnih sistema
Rang:	P05
Trajanje zaposlenja:	Neodređeni period
Odeljenje:	Platni sistem
Odsek:	Nadzor i analiza platnih sistema
Odgovara:	Šefu Odseka

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Ocenjuje, analizira i nadzire platni sistem u celini, pojedinačne instrumente i nove elektronske metode plaćanja koje se koriste u platnom prometu u zemlji;
- Doprinosi izradi politika, pravila i procedura/priručnika za nadzor platnih sistema, u skladu sa međunarodnim standardima, sa fokusom na BIS/CPSS principe za regulisanje i nadzor platnih sistema;
- Vrši procenu platnog sistema u skladu sa pravilima nadzora i prati usklađenost sa važećim zakonodavstvom i propisima kako bi se osiguralo da platni sistemi rade na siguran, stabilan i efikasan način;
- Procenjuje platni sistem i priprema analize rizika, uključujući rizik likvidnosti, operativni rizik, kreditni rizik, pravni rizik i sistemski rizik platnog sistema;
- Osigurava da sistemi garantuju visok stepen operativne sigurnosti i pouzdanosti i da platni sistemi imaju uspostavljene procedure za kontinuitet poslovanja u izuzetnim slučajevima;
- Doprinosi, u saradnji sa Odeljenjem za licenciranje, proceni novih zahteva za registraciju i licenciranje platnih institucija i operatera, kliring i poravnanje hartija od vrednosti, kao i druge platne usluge;
- Doprinosi pregledu i završetku strategije razvoja nacionalnog platnog sistema;
- Doprinosi pripremi i kompletiranju izveštaja o zemlji Evropske komisije i drugih izveštaja međunarodnih organizacija;
- Vrši procenu tehničke i pravne infrastrukture novih učesnika u sistemu;
- Doprinosi istraživačkim projektima koji utiču na smanjenje gotovine u opticaju i pokretanje i promociju elektronskog plaćanja;
- Vodi i uključuje inspekcije banaka i drugih finansijskih institucija koje pružaju usluge platnog prometa, kao i drugih potencijalnih operatera platnog prometa;
- Komunicira i koordinira sa drugim odeljenjima i odsecima CBK-a u vezi sa zahtevima i potrebama koje proizilaze, za nesmetano odvijanje nadzora platnih operatera pojedinačno i sistema u celini;
- U skladu sa standardima EU, analizira mogućnosti novih prilagođavanja tehničke i pravne infrastrukture za efikasniji rad platnog sistema i daje preporuke u vezi sa mogućnostima povećanja kvaliteta platnih usluga;
- Obučava i usmerava novo osoblje odeljenja u pogledu novih izmena/dopuna zakonskog i regulatornog okvira i primene novih nadzornih i analitičkih metodologija;
- Pomaže šefu odeljenja/direktoru u komunikaciji i sastancima sa eksternim stranama (finansijske institucije, operateri/mediji) i internim stranama (odeljenja/odseci) unutar CBK-a;
- Doprinosi izradi godišnjeg plana i godišnjeg izveštaja odeljenja i pripremi evaluacije i individualnog plana razvoja za niže službenike;
- Po potrebi obavlja i druge poslove u vezi sa nadzorom platnih sistema i instrumenata u okviru DPS-a, koje delegira supervizor ili više hijerarhije, ili obaveze koje proizilaze iz okvira opštih radnih obaveza.

Stručno iskustvo/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomskih nauka (menadžment i informatika ili bankarstvo i finansije) ili pravnih nauka;
- Najmanje tri (3) godine iskustva u vezi sa regulatornim okvirom i standardima na Kosovu i u EU za platne usluge, ili druge povezane finansijske instrumente/usluge;
- Prednost će imati kandidati koji imaju iskustvo i znanje u evaluaciji procesa koji zahtevaju izradu analitičkih/statističkih izveštaja, kao i primenu standarda platnih usluga, poželjno iskustvo u bankarskom sektoru
- Organizacione, veštine planiranja i veštine upravljanja vremenom;
- Interpersonalne i komunikacione veštine, kao i veštine rešavanja problema i brzo prilagođavanje novim dešavanjima;
- Tačnost, pažnja na detalje i osetljivost na prioritete;
- Napredno poznavanje korišćenja MS Office softverskih aplikacija;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
- Dobro poznavanje engleskog jezika.

Svi kandidati dostavljaju sledeće dokumente:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske uprave (PUK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate na nivou MONT-a;
- Dokaz identiteta/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Postupak prijave:

- Rok za dostavljanje prijava je **18 april 2025**.
- Prijava se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene veb stranice: www.bqk-kos.org



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Mbikëqyrës/e i/e Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik (dy pozita)
Grada: P06
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti/ Divizioni: Divizioni i Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësie:

Përmbledhje e Pozitës

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është në kërkim të një kandidati të kualifikuar dhe të motivuar për pozicionin e Mbikëqyrësit të Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik në Divizionin e Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së. Ky rol është thelbësor për të siguruar që institucionet financiare nën autoritetin tonë rregullator të mbajnë sisteme informacioni dhe korniza sigurie kibernetike të qëndrueshme, të sigurta dhe në përputhje me kërkesat rregullative. Kandidati i suksesshëm do të jetë pjesë e një ekiye përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rreziqeve të TI-së dhe atyre kibernetike në sektorin financiar, duke siguruar që institucionet përmbushin kërkesat rregullative dhe praktikatat më të mira.

Përgjegjësitë Kryesore

- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i sistemeve të informacionit dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut kibernetik brenda institucioneve financiare për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat rregullative.
- Kryerja e vlerësimeve të rrezikut të TI-së dhe atyre kibernetike, identifikimi i dobësive, kërcënimeve dhe ndikimeve të mundshme në stabilitetin financiar të institucioneve.
- Sigurimi që institucionet e mbikëqyrura të jenë në përputhje me kërkesat rregullative të aplikueshme në vend të sigurisë kibernetike dhe TI-së.
- Monitorimi dhe vlerësimi i përgjigjes së institucioneve ndaj incidenteve kibernetike, duke ofruar udhëzime dhe rekomandime për të zvogëluar rreziqet dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre.
- Bashkëpunimi me palët e interesit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë institucionet financiare, ekspertët e industrisë dhe agjencitë qeveritare, për të promovuar qëndrueshmërinë kibernetike në të gjithë sektorin.
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve mbi vlerësimet e rrezikut të TI-së dhe atij kibernetik për menaxhmentin e lartë, duke theksuar gjetjet kryesore, rekomandimet dhe fushat me shqetësime.

Kualifikimet

- Diplomë universitare në drejtimet si: Shkenca Kompjuterike, Sistemet e Informacionit, Siguria Kibernetike, Financë, ose Administrim Biznesi.
- Certifikimet përkatëse si CISSP, CISM ose CISA janë shumë të dëshirueshme.
- Të paktën 2 vite përvojë në mbikëqyrjen e TI-së, auditim të TI-së, sigurinë kibernetike ose role të ngjashme, preferohet në industrinë e shërbimeve financiare ose në një autoritet rregullator.
- Njohuri mbi sistemet e informacionit, qeverisjen e sistemeve të informacionit, kornizat e sigurisë kibernetike, praktikatat e menaxhimit të rrezikut dhe përputhshmërinë me rregullativën në sektorin financiar.
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe zgjidhje problemesh, me aftësinë për të vlerësuar çështjet komplekse të sistemeve të informacionit dhe atyre kibernetike dhe për të zhvilluar zgjidhje praktike.
- Njohuri të rregulloreve, standardeve dhe udhëzimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e TI-së dhe sigurinë kibernetike.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **18 prill 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv: Supervizor IT sistema i sajber rizika (dve pozicije)
Rang: P06
Trajanje zaposlenja: Neodređeni period
Odeljenje/Odsek: Odsek za nadzor IT sistema
Odgovara: Šefu Odseka

Rezime dužnosti i odgovornosti:

Rezime pozicije

Centralna banka Republike Kosovo traži kvalifikovanog i motivisanog kandidata za poziciju supervizora IT sistema i sajber rizika u okviru Odseka za nadzor IT sistema. Ova uloga je od suštinskog značaja kako bi se osiguralo da finansijske institucije pod našim regulatornim autoritetom održavaju informacione sisteme i okvire sajber bezbednosti koji su stabilni, sigurni i usklađeni sa regulatornim zahtevima. Uspešan kandidat biće deo tima odgovornog za nadzor i procenu IT i sajber rizika u finansijskom sektoru, osiguravajući da institucije ispunjavaju regulatorne zahteve i najbolju praksu.

Glavne odgovornosti

- Nadgleda i procenjuje informacione sisteme i prakse upravljanja sajber rizikom unutar finansijskih institucija kako bi se osigurala usklađenost sa regulatornim zahtevima.
- Sprovdí procene IT i sajber rizika, identifikujući ranjivosti, pretnje i potencijalne uticaje na finansijsku stabilnost institucija.
- Osigurava da nadzirane institucije budu u skladu sa primenjivim regulatornim zahtevima u oblasti sajber bezbednosti i IT-a.
- Prati i procenjuje odgovor institucija na sajber incidente, daje smernice i preporuke za ublažavanje rizika i sprečava njihovo ponavljanje.
- Sarađuje sa internim i eksternim zainteresovanim stranama, uključujući finansijske institucije, stručnjake iz industrije i vladine agencije, kako bi se promovisala sajber otpornost u celom sektoru.
- Priprema i predstavlja izveštaje o IT i sajber procenama rizika višem rukovodstvu, naglašavajući ključne nalaze, preporuke i područja zabrinutosti.

Kvalifikacije

- Diploma iz oblasti računarstva, informacionih sistema, sajber bezbednosti, finansija ili poslovne administracije.
- Relevantni sertifikati kao što su CISSP, CISM ili CISA su veoma poželjni.
- Najmanje 2 godine iskustva u IT nadzoru, IT reviziji, sajber bezbednosti ili sličnim ulogama, po mogućnosti u industriji finansijskih usluga ili regulatornom telu.
- Poznavanje informacionih sistema, upravljanja informacionim sistemima, okvira sajber bezbednosti, praksi upravljanja rizicima i usklađenosti sa propisima u finansijskom sektoru.
- Odlične analitičke veštine i veštine rešavanja problema, sa sposobnošću procene složenih informacionih sistema i sajber problema i razvijanja praktičnih rešenja.
- Poznavanje nacionalnih i međunarodnih propisa, standarda i smernica vezanih za oblast IT i sajber bezbednosti.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeće dokumente:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje i podobnost za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PUK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate na nivou MONT-a;
- Dokaz identiteta/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Procedura prijave:

- Rok za prijavu je **18 april 2025**.
- Prijava se može dostaviti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene veb stranice: www.bqk-kos.org



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli:	Mbikëqyrës/e i/e Sigurimeve
Grada:	P06
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve
Divizioni:	Divizioni për Mbikëqyrje nga Jashtë
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrje nga Jashtë

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Pranon raportet mujore, tremujore dhe vjetore nga të gjithë siguruesit, ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe nga Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS);
- Shqyrton dhe analizon raportet e pranuar nga industria e sigurimeve dhe mbi bazën e tyre përgatit analiza sistemike mujore/tremujore dhe vjetore lidhur me kualitetin dhe saktësinë e raporteve;
- Vlerëson nëse raportet e pranuar nga siguruesit dhe ndërmjetësuesit janë në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Kosovare të Raportimit Financiar dhe kërkesat e përcaktuara përmes Rregulloreve të BQK-së;
- Përgatit raporte tremujore dhe vjetore me treguesit kyç financiar dhe treguesit kryesor të likuiditetit për industrinë e sigurimeve si dhe analizon trendët kryesor të zhvillimit;
- Shqyrton raportet e auditorëve të jashtëm të siguruesve dhe përgatit raport lidhur me kualitetin e tyre;
- Kontribuon në përgatitjen, dizajnin dhe avancimin e formave të raportimeve mujore, tremujore dhe vjetore;
- Pas përgatitjes së raporteve mujore, tremujore dhe vjetore për siguruesit, çështjet dhe dobësitë kryesore të identifikuara në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit i përcjell tek industria e sigurimeve dhe njëkohësisht bën mbikëqyrjen lidhur me implementimin e inputeve;
- Ndihmon në përgatitjen e të gjitha raporteve dhe analizave të kërkuara nga Udhëheqësi i DMJ-së dhe Drejtori i Departamentit.
- Asiston në zhvillimin e Planeve të Zhvillimit Individual (PZHI) për zyrtarët e rinj të mbikëqyrjes së sigurimeve.
- Asiston në vlerësimin e përformancës për zyrtarët e rinj të mbikëqyrjes së sigurimeve.
- Mbështetë udhëheqësin e divizionit në takime dhe konsulta me kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësuesit e tjerë të sigurimeve.
- Angazhohet në grupet punuese, në projekte të ndryshme zhvillimore, përfshirë projektet që kanë të bëjnë me implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- Kryen detyra të tjera të cilat caktohen periodikisht nga udhëheqësi i DMJ-së dhe Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë në drejtimet kontabilitet, financa, menaxhment, administrim biznesi si dhe matematikë financiare;
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit, kontabilitetit ose të menaxhimit të rrezikut në sektorin financiar ose në sektorë tjerë të ndërlidhur me fushat e njëjta.
- Përvoja në institucione financiare paraqet përparësi;
- Preferohet të ketë certifikime në fushën e kontabilitetit, auditimit, menaxhimit të rreziqeve, sigurimeve dhe ri-sigurimeve;
- Aftësi analitike në funksion të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të pasqyrave financiare dhe rreziqeve të institucioneve financiare të mbikëqyrura;
- Njohuri domethënëse të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në funksion të vlerësimit të cilësisë së raportimit financiar dhe analizimit të pasqyrave financiare për qëllime mbikëqyrëse;
- Njohuri domethënëse të kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe standardet e tjera të zbatueshme ndaj siguruesve, dhe ndërmjetësuesve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet aftësi e të kuptuarit dhe zbatimit të procedurave dhe manualit të bazuar në rrezik gjatë analizimit të pasqyrave financiare të siguruesve;
- Përdorë gjykim të drejtë dhe të logjikshëm për të realizuar praktika, objektiva dhe vendime të pavarura;
- Shkathtësi të mira të komunikimit verbal, komunikimit me shkrim, hartimit të raporteve dhe shkathtësi të prezantimit;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në grup me ekipin e ekzaminerëve; aftësi për menaxhimin e kohës lidhur me përfundimin e detyrave të deleguara;
- Njohje e mirë e Microsoft Office dhe softuerëve tjerë relevant në fushën e financave dhe raportimit financiar; dhe
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **18 prill 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv:	Supervizor osiguranja
Rang:	P06
Trajanje zaposlenja:	Neodređeni period
Odeljenje:	Sektor za osiguranje i penzioni nadzor
Odsek:	Odsek za off-site nadzor
Odgovara:	Šefu Odseka za off-site nadzor

Rezime dužnosti i odgovornosti:

- Prima mesečne, tromesečne i godišnje izveštaje od svih osiguravača, posrednika u osiguranju i Kosovskog biroa za osiguranje (KBO);
- Pregleduje i analizira izveštaje primljene od sektora osiguranja i na osnovu njih priprema mesečne/tromesečne i godišnje sistemske analize u pogledu kvaliteta i tačnosti izveštaja;
- Procenjuje da li su izveštaji primljeni od osiguravača i posrednika u skladu sa Međunarodnim standardima finansijskog izveštavanja, kosovskim standardima finansijskog izveštavanja i zahtevima navedenim u uredbama CBK-a;
- Priprema tromesečne i godišnje izveštaje sa ključnim finansijskim pokazateljima i ključnim indikatorima likvidnosti za industriju osiguranja i analizira ključne trendove razvoja;
- Razmatra izveštaje eksternih revizora osiguravača i priprema izveštaj o njihovom kvalitetu;
- Doprinosi pripremi, dizajniranju i unapređenju mesečnih, tromesečnih i godišnjih izveštajnih obrazaca;
- Nakon pripreme mesečnih, tromesečnih i godišnjih izveštaja za osiguravače, glavne probleme i slabosti identifikovane u koordinaciji sa šefom odseka prosleđuju se industriji osiguranja i istovremeno se vrši nadzor nad implementacijom inputa;
- Pomaže u pripremi svih izveštaja i analiza koje zahtevaju šef Odseka za off-site nadzor (OSSD) i direktor odeljenja.
- Pomaže u izradi Individualnih razvojnih planova (IRP) za nove službenike nadzora osiguranja.
- Pomaže u evaluaciji rada novih službenika za nadzor osiguranja.
- Podržava šefa odeljenja na sastancima i konsultacijama sa osiguravajućim društvima i drugim posrednicima osiguranja.
- Učestvuje u radnim grupama, u različitim razvojnim projektima, uključujući projekte koji se odnose na implementaciju Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja.
- Obavlja i druge poslove koje periodično odredi šef OSSD i direktor Sektora za osiguranje i penzioni nadzor.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije u oblasti računovodstva, finansija, menadžmenta, poslovne administracije i finansijske matematike;
- Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti revizije, računovodstva ili upravljanja rizicima u finansijskom sektoru ili u drugim sektorima koji se odnose na iste oblasti.
- Iskustvo u finansijskim institucijama će se smatrati prednošću;
- Poželjni su sertifikati iz oblasti računovodstva, revizije, upravljanja rizicima, osiguranja i reosiguranja;
- Analitičke veštine u funkciji nadzora i procene finansijskih izveštaja i rizika nadziranih finansijskih institucija;
- Značajno poznavanje Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI), u cilju procene kvaliteta finansijskog izveštavanja i analize finansijskih izveštaja u nadzorne svrhe;
- Značajno poznavanje pravnog i regulatornog okvira, kao i drugih standarda koji se primenjuju na osiguravače i posrednike za procenu njihove usklađenosti;
- Sposobnost razumevanja i implementacije procedura i priručnika zasnovanih na riziku kada se analiziraju finansijski izveštaji osiguravača;
- Koristi pravedno i logično prosuđivanje za sprovođenje praksi, ciljeva i nezavisnih odluka;
- Dobre veštine verbalne komunikacije, pismene komunikacije, pisanja izveštaja i veštine prezentacije;
- Sposobnost da se efikasno radi kao tim sa timom ispitivača; veštine upravljanja vremenom koje se odnose na izvršavanje delegiranih zadataka;
- Dobro poznavanje Microsoft Office-a i drugog relevantnog softvera iz oblasti finansija i finansijskog izveštavanja; i
- Poznavanje engleskog jezika smatraće se prednošću.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeće dokumente:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje i podobnost za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske uprave (PUK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate na nivou MONT-a;
- Dokaz identiteta/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Procedura prijave:

- Rok za prijavu je **18 april 2025**.
- Prijava se može dostaviti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene veb stranice: www.bqk-kos.org



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania Spitali regjional “Prim. Dr. Daut Mustafa” - Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për inseneratori-impanti për trajtimin e mbetjeve spitalore në spitalin e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.05.2025 në ora 10:00 në Objektin e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit, tek zyra e Telemjeksisë do të organizohet debat publik nga Kompania Spitali regjional “Prim. Dr. Daut Mustafa” - Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us05web.zoom.us/j/85727817221?pwd=jSpqwLvWteDg9rZFGShH2lCIP4RfQ.1>

Meeting ID: 857 2781 7221

Passcode: spitalipz

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë Spitali regjional “Prim. Dr. Daut Mustafa” - Prizren për inseneratori-impanti për trajtimin e mbetjeve spitalore në spitalin e Prizrenit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arben Rapi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fadil Hisari” në Prizren.

Gentrit Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Remzi Ademaj” Prizren.

Hajrije Peci shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore Trepça ish shkolla fillore “Mosha Pijada”.

- Kismete Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Ali Hasi” Cremjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Ujkan Lila B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik Identifikues të Biznesit me nr. 812005305 të lëshuar nga ARBK.

- Bernard Paloka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Dulë Gjuraraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II të sh.f.m.u. “Shaban Gola” Lipavec KK Gjakovë.

- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L